



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

|                      |   |                                   |
|----------------------|---|-----------------------------------|
| Për:                 | Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës<br>Arbëneshja Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës           |                                   |
| Kopje:               | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë                  |                                   |
| Përmes:              | Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së<br><br>Jeton Qela, Ud. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL                            |                                   |
| Nga:                 | Erbllin Hetemi, U. d. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL                              | Datë:<br>20.06.2024<br>VI-020-377 |
| Zyrtaret përgjegjës: | 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor                                   |                                   |
|                      | Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br><br>Vjosa Ahmetaj, Zyrtare për Monitorim të Komunave |                                   |
| Lënda:               | Kërkesë për rishqyrtim  |                                   |
| Lloji i aktit:       | Vendim i kuvendit të komunës së Gjakovës  |                                   |

I nderuar Kryetar,  
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullosës (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

|  |
|--|
| Vendim përfundimtar Nr. 01-011/01-8536 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale me numër të parcelës P-70705029-016371-1 |
| I miratuar më datë: 30.05.2024   |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04.06.2024   |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.



## Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Gjakovës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2024, ka miratuar Vendimin përfundimtar Nr. 01-011/01-4933 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale P-70705029-016371-1.

MAPL, konstaton se vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës është në kundërshtim me Ligjin nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2022 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës:

Vendimi i miratuar është bazuar në nenin 19 paragrafi 3 ku i Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenet 21 dhe 22 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2022 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, të cilat sqarojnë procesin e vlerësimit të ofertave, ndërsa procedurat të cilat janë zhvilluar për këtë dhënie të pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë janë bërë sipas ankandit publik, është plotësuar ndryshuar vetëm Vendimi i Kuvendit, mirëpo i terë procesi i zhvilluar është për ankand publik përfshirë edhe njoftimi publik për palët e interesit.

Andaj obligoheni të zhvilloni të gjitha procedurat sipas legjislacionit për dhënie të pronës në shfrytëzim afatgjatë përmes shprehjes së interesit.

Andaj bazuar në të lartcekurat, Kuvendi i Komunës së Gjakovës duhet të ndërmerr veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbete në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
 REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
 KOMUNA E GJAKOVËS  
 OPŠTINA GJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



**Kuvendi i Komunës së Gjakovës**

01 Nr. \_\_\_\_\_ /2024

**Datë: 30.05.2024**

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënie në shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe nenin 21 dhe 22 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2022 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2024, pas diskutimit lidhur me pikën 8-të rendit të ditës: Rishqyrtimi i Vendimit Përfundimtar për dhënie në shfrytëzim të pronës së Paluajtshme Komunale 01nr.011/01-1933 i datës 28.03.2024, e miratoi këtë:

**V E N D I M**

Përfundimtar për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës Komunale.

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës miraton vendimin e korigjuar sipas rekomandimeve të MAPL-së për vendimin përfundimtar për Dhënie në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale me numër të parcelës P-70705029-016371-1, ofertuesit: D&T Group SH.P.K, OSMANI CONSTRUCTION SH.P.K dhe KAN GROUP SH.P.K të rekomanduar nga Komisioni Vlerësues i oferta me e favorshme.
2. Afati kohor për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme Komunale të cekur në pikën e 1 të këtij Vendimi është në kohëzgjatje prej 99 (nëntëdhjetenëntë) viteve.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të Pronës Komunale të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është siç përcaktohet në vendimin paraprak me numër 01-020-37472 të datës 25.07.2016, funksionalizimi i pronës, ndërtimi i objektit me destinim – objekt banimi shumë banesor me afarizëm.
4. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë: Rekomandimi dhe dokumentet tjera të Komisionit Vlerësues dhe oferta e përzgjedhur së bashku me korigjimin e gabimit teknik në njoftimin Publik.
5. Autorizohet Kryetari i Komunës së Gjakovës që brenda 10 ditë pune nga hyrja në fuqi e këtij vendimi të lidhet kontrata me fituesin, me anë të së cilës përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.
7. **Vendimi iu dërgohet:**
  - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini.
  - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
  - Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë .
  - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
  - Arkivit .

Arbëneshja Kuqi  
 Kryesuesja e Kuvendit të Komunës